

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 3385 Data 21.04.2026
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, neni 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., neni 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 2778 të datës 26.05.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stantërg, Trepça Sh.A me datë 21.04.2026 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Udhëheqës i përgatitjes së mostrave dhe analitikes
Koeficienti/Paga:	670€ bruto
Nr. i kërkuar:	2
Kohëzgjatja e emërimit:	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit:	21.04.2026
Afati për aplikim:	22.04.2026 – 06.05.2026
Institucioni:	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore:	Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
Vendi i punës:	Stan Tërg

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Përgjigjet për përgatitjen e tretjeve apo reagensave të nevojshëm për kryerjen e të gjitha analizave kimike në Laborator;
- Bënë përgatitjet e tretjeve dhe reagentave për analizat në volumetri;
- Përgatitjen e tretjeve dhe reagensave në kompleksometri;
- Përgatitjen e standardeve për graviometri;
- Përcakton standardin e reagensave për volumetri dhe kompleksometri;
- Për analiza Instrumentale për të gjitha elementet (Pb, Zn, Fe etj.)
- Asiston në punët që bëhen në Absorber Atomik;
- Përgatit tretjet, standardet bazë për Absorber Atomik (të të gjitha elementeve);
- Punon me aparatën e destilimit të ujit për nevojat e laboratorit;
- Përgjigjet për sigurimin e të gjitha reagensave dhe enëve laboratorike (furnizimi);

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë universitare - inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore apo master, kimist i diplomuar apo master, biolog i diplomuar apo master si dhe çdo drejtim tjetër relevant i shkencave natyrore;
- Duhet të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale;

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
 - Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
 - Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
 - Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
 - CV-Biografia;
 - Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
 - Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose
 - nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.
-

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim- 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Indurstial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00.

